

## Çështja e Hadithit dhe e politikës

islamicdiscourseinitiative.com

Një shqetësim që rregullisht shpërfaqet në diskutime rreth besueshmërisë së burimeve themelore të hershme islamike është pohimi se autorësia e atyre burimeve ishte nën ndikimin e qeverive dhe autoriteteve politike të kohës. Thirrje të këtilla vejnë në dyshim integritetin e atyre burimeve dhe imponojnë pyetjen: Si të mbështetemi në burime që kishin mundësinë e ndikimit nga një mori faktorësh të jashtëm, të cilët mund të kenë komprometuar integritetin dhe shenjtërinë e përmbajtjeve të tyre?

Shqetësimet e këtilla janë të kuptueshme. Megjithatë, hapi tjetër do të ishte verifikimi i këtij pohimi dhe vlerësimi i drejtpërdrejtë i burimeve kryesore për indikatorë që ofrojnë më shumë qartësi në këtë çështje. Nëse koleksionet e hershme të koleksioneve të Hadithit u punuan nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë dhe ndikimin e qeverive të kaluara, atëherë do të ishte e pritshme të shihje trende të caktuara së bashku me një shumëllojshmëri indikatorësh dhe fenomenesh në këto tekste, si për shembull:

1. Sasia e shumtë të transmetimeve “pro-qeveritare” që promovojnë interesat e qeverive që ekzistonin në kohën kur u punuan këto burime.
2. Mungesa/sasia e pakët e transmetimeve “anti-qeveritare” që bien ndesh me interesat e atyre qeverive.
3. Lidhja e fortë mes autorëve të koleksioneve të Hadithit dhe autoriteteve qeveritare përkatëse.
4. Të cilësuarit (e njëanshëm) e transmetimeve “pro-qeveritare” si të vërteta nga autoritetet e hershme të Hadithit.

Mungesa e këtyre fenomeneve në korpusin klasik të Hadithit ndoshta mund të jetë i mjaftueshëm për të rishikuar vlerën e pohimeve të përmendura më lart. Në fakt, ekzistenca e fenomeneve të kundërta në këto burime mund të shërbejë në hedhjen poshtë të tërë narrativit lidhur me kompilimin e Hadithit.

### **Sasia e shumtë e transmetimeve “anti-qeveritare” në koleksionet e Hadithit**

Nuk është në interes të qeverive që të shpërndajnë dhe të qarkullojnë transmetime që nuk përputhen me interesat e tyre. Transmetimet e këtilla “anti-qeveritare” përfshijnë transmetime që kanë mundësi potenciale ta minojnë autoritetin, legjitimitetin ose ndikimin e qeverive. Kështu, sasia e shumtë e transmetimeve të këtilla në burimet e hershme islamike shërbejnë si një tregues

për atë se autorësia e këtyre burimeve nuk ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të autoriteteve politike të kohës.

Një analizë e kujdesshme e koleksioneve të hershme të Hadithit do të paraqesë një vistër të gjerë transmetimesh që mund të etiketohen si transmetimeve “anti-qeveritare”. Këto transmetime dallojnë nga natyra; disa u drejtohen pushtetarëve muslimanë duke u atribuar një standard më të lartë të përgjegjësisë. Të tjera transmetime u drejtohen publikut muslimanë duke i inkurajuar t’u shmangen pushtetarëve të korruptuar dhe t’i kundërshtojnë autoritetet politike që i urdhërojnë për gjëra që për Allahun janë të papëlqyeshme. Transmetimet e këtilla shpesh vejnë në pah urdhërimin për mirë dhe ndalimin e së keqes.

Tarik bin Shihab përcolli se një burrë pyeti peygamberin ﷺ: “Cili është xhihadi më i mirë?” Peygamberi ﷺ u përgjigj: “Një fjalë e vërtetë e shprehur para një pushtetari tiran.”

Ka’b ibn Axhrah tha: “I Dërguari i Allahut na erdhi ndërsa ishim në një grup prej nëntë vetash. Një pjesë ishin arabë, pjesë tjetër joarabë. I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Dëgjomëni. A keni dëgjuar se do të ketë pushtetarë pas meje? Kushdo që hyn te ta dhe u beson atyre në pavërtetësitë e tyre dhe u ndihmon në tiraninë e tyre, ai s’ka të bëjë gjë me mua dhe as unë me të; i këtilli s’do të më afrohet tek Pellgu (el-Keuther). Kushdo që nuk hyn te ta, nuk u ndihmon në tiraninë e tyre dhe nuk i beson pavërtetësitë e tyre, ai është imi dhe unë jam i tij; i këtilli do të më afrohet te Pellgu (el-Keuther).”

Pasi përcolli këtë transmetim, et-Tirmidhi tha: “Ky hadith është *Sahih Garib* ...”

Tarik bin Shihab tha: “Njeriu i parë që mbajti hutbe para namazit të Bajramit qe Merwan bin el-Hakem. Një burrë u çua dhe it ha: “Kundërshtove Sunetin!” Merwan ia ktheu: “Është lënë (kundërshtuar) para meje.” Ebu Sa’id el-Khudri tha: “Për sa i përket këtij burri (që u çua dhe foli), ky kreu detyrën e vet. Dëgjova të Dërguarin e Allahut ﷺ të thoshte: ‘Kushdo që sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e vet. Nëse s’mund ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e vet. Nëse s’mund ta bëjë as këtë, atëherë me zemrën e vet, dhe ky është imanin më i dobët.’”

El-Hasan el-Basri tha: “Vizitua Me’kal bin Jaserin (sa ishte sëmurë). Aty erdhi edhe Ubejdullah bin Zijadi (gubernatori i Basras) dhe Me’kal i tha: ‘Do të ta tregoj një hadith që dëgjova nga i Dërguari i Allahut, i cili tha: ‘S’ka ndonjë pushtetar që merr udhëheqjen e muslimanëve dhe vdes duke i mashtruar ata veçse Allahu do t’ia ndalojë hyrjen në Xhenet.’”

Ibn Umer ﷺ përcolli se i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Secili prej jush është një kujdestar dhe secili prej jush do të pyetet për detyrat që ka pasur. Një pushtetar është kujdestar dhe do të pyetet për të nënshtruarit e tij. Një burrë është kujdestar i familjes së tij dhe do të pyetet për të. Një grua është kujdestare e shtëpisë së burrit dhe ajo do të pyetet për të. Një shërbëtor është kujdestar i pronës së zotërisë së tij dhe ai do të pyetet për të. Vërtet të gjithë ju jeni kujdestarë dhe do të pyeteni për detyrat tuaja.”

Ibn Umer përcolli se i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Është obligim i muslimanit që të bindet dhe të dëgjojë (pushtetarin) në atë që pëlqen dhe nuk pëlqen, për sa kohë që të mos urdhërohet të bëjë ndonjë gjynah. Nëse urdhërohet për të bërë një gjynah, atëherë nuk duhet t’i bindet (pushtetarit) e as ta dëgjojë.” (Ibn Ebi Shejbeh 543)

### **Kritika ndaj transmetimeve “pro-qeveritare”**

Një fenomen tjetër i dallueshëm në kompilimin e Hadithit është kritika ndaj transmetimeve “pro-qeveritare” të përcjella nga kritikët e hershëm të Hadithit. Sikur Muhadithinët (hadithologët) të ishin pjesë e një komploti më të madh për të fabrikuar dhe qarkulluar hadithe që u japin shtysë interesave të qeverive të tyre, atëherë s’do të pritje të shihje kritikët e Hadithit t’i kritikojnë dhe t’i cilësojnë si të dobëta transmetimet e tilla në punimet e tyre, meqë kjo do të ishte paradoksale. Më parë ne do t’i shihnim ata duke i cilësuar njëanshëm si të vërteta këto transmetime, pasi ato do t’i fuqizonin interesat e qeverisë.

Në librat e Hadithit gjejmë hadithologë dhe kritikë të Hadithit t’i cilësojnë si të dobëta dhe t’i kritikojnë transmetimet e tilla në shumë raste.

Në *ilel el-Hadith*, Ibn Ebi Hatim tha:

“Pyeta babanë tim rreth një hadithi të përcjellë nga Khalid bin Khidesh, nga Ebu Aun bin Ebi Rukbah, nga Gejlen bin Xherir, nga Enes se i Dërguari i Allahut tha:

“Sultani (pushtetari) është hija e Allahut në tokën e Tij.”

Ebu Hatim komentoi duke thënë: “Ky hadith është *munker* (i papranueshëm), meqë Ibn Ebi Rukbah është i panjohur.”

Në një tjetër rast, Ibn Ebi Hatim po ashtu tha:

“Pyeta babanë tim rreth një hadithi të përcjellë nga Ebu Samir, nga Abdul-Malik bin Umejir, nga el-Rebi bin Umejleh, nga Abdullah bin Mes’ud se i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Ju do të sundoheni nga pushtetarë që do të shkaktojnë çrregullime, por e mira që Allahu do të drejtojë nëpërmjet tyre është më e madhe (sesa çrregullimet e tyre). Kushdo prej tyre që bën mirë, do të marrë shpërblimin e vet dhe ti duhet të jesh mirënjohës. Kushdo prej tyre që vepron ndryshe, do t’i takojë gjynahu, ndërsa ti duhet të durosh.”

Ebu Hatim u përgjigj duke thënë: “Ky hadith është *munker* (i papranueshëm). Ebu Samir nuk përfillet (në përcjelljen e haditheve).”

Në *el-Muntekheb min ilel el-Khallal*, el-Khallal citohet të ketë cituar Muhanna bin Jahja duke thënë:

“Pyeta Jahjanë (ibn Ma’in) rreth Habib bin Khalid el-Tahhan dhe më tha: ‘E kam takuar dhe kam dëgjuar hadithin prej tij. Ai është nga banorët e Kufës dhe ka një hadith të cilin e kemi dëgjuar nga ai.’ Pyeta: “Si është puna e tij?” Jahja u përgjigj: “Më është thënë se ai ka përcjellë një hadith *munker* (të papranueshëm) nga el-A’mesh. Ai e përcolli nga el-A’mesh, nga Zejd bin Weheb, nga Hudhejfe i cili tha: ‘Nuk është nga Suneti që të rrokësh armën kundra pushtetarit.’”

Ky hadith nuk njihet si transmetim nga el-A’mesh. Ky është një transmetim nga Sufjan, nga Habib bin Ebi Thebit, nga Ebu el-Bektari, nga Hudhejfe.”

Muhanna tha: “Pyeta Ahmedin (ibn Hanbel) dhe Jahjanë (ibn Ma’in): “A e ka dëgjuar këtë Ebu el-Bektar nga Hudhejfe?” Thanë: “Jo”. Pastaj pyeta: “A e ka dëgjuar Zejd bin Weheb nga Hudhejfe?” Thanë: “Po.”

Në shembullin e mësipërm, Muhanna ibn Jahja citon Jahja ibn Ma’inin duke deklaruar të jetë *munker* (i papranueshëm) transmetimi “Nuk është prej Sunetit të rrokësh armën kundra pushtetarit”. Jahja më pas vazhdon të përvijojë interpretimin korrekt të transmetimit, të cilin ai (dhe Ahmedi) vazhduan ta cilësonin si të dobët, për shkak të ndërprerjes në zinxhirin e transmetimit.

Kur trajton transmetimin ku pejgamberi ﷺ citohet të ketë thënë “Dëgjo dhe bindu (pushtetarit), edhe nëse ta rrahë shpinën dhe ta merr pasurinë,” el-Darekutni thotë:

“Muslimi përcolli hadithin nga Mu’awijeh bin Sel’lem, nga Ebu Sel’lem, i cili tha: ‘Hudhejfe tregoi: ‘Ne kemi qenë në gjendje të keqe, pastaj Allahu na solli mirësi ...’”

El-Darekutni pastaj tha: “Sipas mendimit tim, ky hadith është *mursel* (i ndërprerë), sepse Ebu Sel’lem nuk ka dëgjuar nga Hudhejfe e as nga ndonjë prej bashkëkohësve të tij që u vendosën në Irak. Kjo sepse Hudhejfe vdiq disa net pas vrasjes së Uthmanit ...”

Në këta shembuj më lart (ndër të shumtët) shohim disa nga kritikët më të shquar të Hadithit të kritikojnë transmetime që drejtpërsëdrejti ndërlidhen me interesat e qeverisë. Përndryshe, transmetimet e këtilla do të mund të përdroreshin nga pushtetarët dhe nga autoritetet qeveritare për të promovuar ato interesa. Fakti se këto hadithe u kritikuan dhe, madje, u përgënjeshtroan nga kritikët e hershëm të Hadithit tregon se këta hadithologë nuk qenë motivuar nga një anim i supozuar “pro-qeveritar”, kur kategorizuan transmetimet.

## Raportet e hadithologëve me autoritetet qeveritare

Në vlerësimin e pohimit se kompilimi i Hadithit që nën ndikimin e drejtpërdrejtë të autoriteteve të kaluara qeveritare, duhet pasur parasysh raportet që hadithologët kishin me qeveritë e tyre përkatëse. Sikur autorët e koleksioneve të Hadithit të kishin qenë pjesë e një komploti më të madh qeveritar për të sajuar dhe qarkulluar transmetime që promovojnë interesa qeveritare, ne do të duhej të shihnim një marrëdhënie shumë të ngushtë mes hadithologëve dhe qeverive të tyre.

Në të vërtetë, transmetuesit dhe kompiluesit më të mëdhenj të Hadithit shpesh dallonin në animet e tyre politike/teologjike. Dallimet manifestohen në llojlojshmërinë e burimeve nga të cilat korpusi Sunit i Hadithit merr materialin e vet. Për rrjedhim, hadithologët nuk qenë të njësojtë për sa u përket raporteve të tyre me autoritetet qeveritare.

Në tezën e tij të doktoratës, të titulluar *el-Muhaddithun wel-Sijaseh*, Dr. Ibrahim el-Axhlan ndan hadithologët në pesë kategori të mëdha për sa u përket raporteve që ata kishin me autoritetet qeveritare:

- Transmetues të cilët haptazi bashkëpunonin me autoritetet qeveritare në interes të publikut (el-Axhlan 48)
- Transmetues të cilët i shmangeshin çfarëdo forme të ndërveprimit ose shoqërimit me autoritetet qeveritare dhe me institucione (el-Axhlan, 59)
- Transmetues të cilët kritikonin dhe këshillonin zyrtarë qeveritarë (el-Axhlan 65)
- Transmetues të cilët refuzonin dhurata dhe emërime në poste zyrtare nga zyrtarë qeverie (el-Axhlan 87)
- Transmetues të cilët morën pjesë në revolta të armatosura kundër autoriteteve (el-Axhlan 96)

Në secilën nga këto kategori, Dr. Axhlan përvijon shumë transmetues eminentë dhe të vyer. Për të demonstruar këtë pikë, po përmendim disa nga emrat që el-Axhlan përfshiu në kategorinë e fundit, ku hyjnë transmetues të cilët morën pjesë në revolta të armatosura kundër autoriteteve. Në këtë kategori, ai liston një sërë figurash, si: Sa'id bin Xhubejr, Amir el-Sha'bi, Abdu-Rrahman ibn Lejla, Xhabir ibn Zeid, Abdul-Aziz el-Darawerdi, Muhamed bin Amr bin Alkameh, Muhamed bin Axhlan, Jezid bin Harun, Ebu Khalid el-Ahmar, etj.

Këto kategori të ndryshme shërbejnë për të demonstruar faktin se përgjithësimet e këtilla kundër korpusit të Hadithit nuk janë të sakta e as nuk përfaqësojnë realitetin. Përgjatë historisë, shumë nga hadithologët eminentë dhe kompilues të Hadithit janë përplasur drejtpërsëdrejti me qeveritë e tyre përkatëse. Madje, kompiluesit e shquar të Hadithit, si: Malik Ibn Enes, Sufjan eth-Theuri, Ahmed ibn Hanbel dhe të tjerë u persekutuan nga qeveritë e tyre në etapa të ndryshme të historisë.

### **Kritika ndaj transmetuesve që u përfshinë në çështje qeveritare**

Një tjetër fenomen që vlen të përmendet dhe duhet të studiohet, kur vlerësohen raportet që hadithologët patën me qeveritë e tyre përkatëse, është qëndrimi i hadithologëve ndaj transmetuesve të cilët qenë të përfshirë drejtpërsëdrejti në çështje qeveritare. Në burimet biografike të Muslimit, mund të gjenden disa shembuj të haditheve të kritikëve të Hadithit, ku transmetues të caktuar kritikohen vetëm për shkakun se u përfshinë me “sultanin” dhe me të tjera institucione qeveritare. Fakti se identifikimi me një institucion qeveritar dashamirës mjaftonte që një transmetues të kritikohet nga disa kritikë të Hadithit mund t’i qartësojë gjërat lidhur me raportet që hadithologët kishin me autoritetet qeveritare në kohët e tyre.

Jahja ibn Ma’in tha: “Parapëlqej transmetimin e el-Mensur nga Ibrahim, nga Eswed, nga Aisha, para transmetimit të Hisham bin Urwes, nga babai i tij, nga Aisha.” Jahja u pyet: “Çfarë mendon për transmetimin e el-Zuhrit nga Urwe, nga Aisha?” Ai u përgjigj: “Janë njësoj, por parapëlqej Mensurin, sepse el-Zuhri ishte një *sultanij* (përzihej me pushtet).”

Abdullah ibn Ahmed tha: “Pyeta babanë tim (Imam Ahmedin) për Khalid el-Tahhanin dhe për Hushejmin se cili ishte më i mirë dhe ai mu përgjigj: “Preferojmë Khalidin, sepse nuk përzihej në asnjë nga çështjet e pushtetarit.”

Në tezën e tij, Dr. Ibrahim el-Axhlan liston edhe shembuj të tjerë që ne s’i kemi hasur (el-Axhlan 260):

Jahja bin Sa’id tha: “Muhamed ibn Sirin nuk miratonte Humejd ibn Hilalin.” Më pas, Ibn Ebi Hatim tha: “Ia përmenda këtë babait tim dhe ia ma ktheu: “Ai përzihej në çështjet e sultanit dhe kjo ishte arsyeja përse ai nuk e miratonte, ndonëse ishte i besueshëm në përcjelljen e hadithit.”

Ebu Arubah përshkroi Ibn el-Bennanë duke thënë: “Ai, në vetvete, nuk është i besueshëm.” Ibn Adij më pas komentoi duke thënë: “Për sa i përket deklaratës së Ebu Arubas ‘Ai, në vetvete, nuk është i besueshëm’, ai (Ibn el-Benna) fillimisht kreu disa punë të sultanit, siç janë portet (detare) dhe disa çështje të tjera. Pra, Ebu Arubah iu referua thjesht vetëm përzierjes së tij me sultanin.”

Këta shembuj shërbejnë për të demonstruar faktin se disa nga hadithologëve dhe kritikëve më të shquar të Hadithit nuk u pëlqenin transmetuesit që bashkëpunonin dhe rregullisht bashkëpunonin me institucione qeveritare.

Ka një sasi të madhe të deklarimeve të tjera të përgjithshme nga shumë hadithologë të shquar, ku ata shprehin më tej ndjenjat e tyre lidhur me bashkëpunimin me autoritetet qeveritare, mirëpo këta shembuj do të mjaftojnë si shembull i këtij fenomeni.

## Konkluzion

Në verifikimin e pohimit se autorësia e burimeve kryesore islamike ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të autoriteteve qeveritare të kohës, gjejmë se të dhënat kundërshtojnë këto pohime konspirative. Tregues të shumtë të cituar në këtë dokument (krahas edhe shumë të tjerëve) hedhin poshtë këtë narrative të pasaktë, që keqinterpretin integritetin e burimeve të hershme islamike. Është më se e qartë që shumë nga hadithologët e shquar vepruan në punimet e tyre pavarësisht autoriteteve qeveritare.

### **Punimet e cituara**

El-Axhlan, Ibrahim bin Salih. *El-Muhaddithun wel-Sijaseh*, botimi i 1rë, vëll. 1 1, *Risalet el-Bejan*, 2017.

El-Bezzar, Ahmed bin 'Amr. *Musned el-Bezzar*, redaktuar nga Adil Saad, botimi i 1rë, vëll. 12 18, *Mektebet el-Ulum wel-Hikmeh*, 2009.

El-Bukhari, Muhammad bin Isma'il. *Sahih el-Bukhari*, redaktuar nga Muhamed Zuhejr el-Naser, botimi i 1rë, vëll. 9 9, *Dar Tewk el-Nexhah*, 2001.

El-Darakutni, Ali bin 'Umer. *El-ilzamat wel-Tetebbu'*, redaktuar nga Mukbil bin Hadi el-Wadi'i, botimi i 2të, vëll. 1 1, *Dar el-Kutub el-ilmijeh*, 1985.

El-San'ani, 'Abdurrezzak. *El-Musenef*, redaktuar nga Habib el-Rrahman el-Azmi, botimi i 2të, vëll. 3 11, *El-Mekteb el-Islami*, Beirut, 1983.

Al-Tirmidhi, Muhamed ibn 'Isa. *El-Xhami' el-Kebir*, redaktuar nga Beshar Awwad Maruf, vëll. 4, *Dar el-Gharb el-Islami*, 1998.

Ibn Ebi Hatim, 'AbduRrahman. *El-Xherh Wel-Ta'dil*, botimi i 1rë, vëll. 3 9, *Dar Ihjaa' el-Turath el-'Arabi*, 1952.

*'ilel el-Hadith*, redaktuar nga Saad el-Humajjid dhe Khalid el-Xhurejsi, botimi i 1rë, vëll. 6 7, *Metebi' el-Homeidhi*, 2006.

Ibn Ebi Shejbeh, 'Abdullah. *El-Musannef fi el-Ahadith wel-Ether*, redaktuar nga Kemal el-Hut, botimi i 1rë, vëll. 6 7, *Mektebet el-Rushd*, 1988.

Ibn 'Adij, 'Abdullah. *El-Kamil fi Du'afaa' el-Rixhaal*, redaktuar nga Adil Abdul-Mewxhud dhe Ali Mewadh, botimi i 1rë, vëll. 7 9, *El-Kutub el-'ilmijeh*, 1997.

Ibn El-Xhunejd, Ibrahim. *Su'alat Ibn el-Xhunejd li-Ebi Zekerijje*, Jahja bin Ma'in. Redaktuar nga Ahmed Saif, botimi i 1rë, vëll. 1 1, *Mektebet el-Dar*, Medina, 1988.

Ibn Hanbel, Ahmed. *Musned Ahmed*, redaktuar nga Shuajb el-Arnaut dhe Adil Murshid, botimi i 1rë, vëll. 31 45, *Muesseset el-Risaleh*, 2001.

*El-'ilel we Ma'rifet el-Rixhel*, Riwayat 'Abdullah. Redaktuar nga Wesiullah Abbas, botimi i 2të, vëll. 1 3, *Dar el-Khani*, 2001.

Ibn Kudameh, 'Abdullah. *El-Muntekheb min 'ilel el-Khallal*, redaktuar nga Tarik Awadallah, botimi i 1rë, vëll. 1 1, *Dar el-Rejah*, 1998.